



QKLL 2025

GUSHT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

20-23 GUSHT 2025 / PANAIRI VEROR I LIBRIT NË SHËNGJIN



Panairi Veror i Librit, një ngjarje e rëndësishme kulturore u zhvillua në Shëngjin në datat 22-23 gusht, në Shëtitoren Wilson, me rreth 20 shtëpi botuese. Ishin të ftuar të vizitonin standat e Panairit turistë, banorë, miq të librit, shkrimtarë, studiues, përkthyes dhe lexues të të gjitha moshave.

Në Shëngjin – mes plazhit dhe fuqisë së fjalës së shkruar!

27 GUSHT 2025 / TAKIM ME SHEFEN E KATEDRËS SË ALBANOLOGJISË NË MYNIH, ENKELEIDA KAPIA



U mirëprit në hapësirat e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit Enkeleida Kapia, shefe e Katedrës së albanologjisë në Mynih në universitetin elitare Ludwig-Maximilians, e cila është gruaja e parë që drejton këtë katedër pas viteve të tëra që u drejtua nga zoti Bardhyl Demiraj.

5 GUSHT 2025 / VEPRA “RIDËNIMI” E AUTORIT FATOS LUBONJA, E PËRKTHYER NË POLONISHT ME MBËSHTETJEN E QKLL




Vepra “Ridërimi” (Drugi wyrok) i autorit Fatos Lubonja është përkthyer në gjuhën polake me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit falë “Fondit të Përkthimit Letrar nga Gjuha Shqipe në Gjuhë të Huaj”, një fond i përvitshëm nga QKLL.

20 gusht 2025 / Mbrëmje poetike në qytetin e Elbasanit



Klubet e leximit - një formë e bukur për të përsosur raportin me leximin. Një mbrëmje poetike në qytetin e Elbasanit, ku u bënë bashkë artdashës dhe mjaft të rinj që gjejnë prehje në rreshtat e librave.

12 gusht 2025 / Tregimet e Ramiz Gjinit – të lexojmë autorët shqiptarë





QKLL 2025

GUSHT



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

20-23 GUSHT 2025 / PANAIRI VEROR I LIBRIT NË SHËNGJIN



Panairi Veror i Librit, një ngjarje e rëndësishme kulturore u zhvillua në Shëngjin në datat 22-23 gusht, në Shëtitoren Wilson, me rreth 20 shtëpi botuese.

Ishin të ftuar të vizitonin stendat e Panairit turistë, banorë, miq të librit, shkrimtarë, studiues, përkthyes dhe lexues të të gjitha moshave.

Në Shëngjin – mes plazhit dhe fuqisë së fjalës së shkruar!



QKLL 2025

GUSHT

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



5 GUSHT 2025 / “VEPRA “RIDËNIMI” E AUTORIT FATOS LUBONJA, E PËRKTHYER NË POLONISHT ME MBËSHTETJEN E QKLL



Vepra “Ridënimi” e autorit Fatos Lubonja, e përkthyer në polonisht, është një prej 14 librave të nominuar për çmimin letrar “Angelus” 2025, çmimi për Letërsinë e Europës Qendrore.

“Ridënimi” (Drugi wyrok) i autorit Fatos Lubonja është përkthyer në gjuhën polake me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit falë “Fondit të Përkthimit Letrar nga Gjuha Shqipe në Gjuhë të Huaj”, një fond i përvitshëm nga QKLL.

Ky libër që vjen në gjuhën polake nën përkthimin e Dorota Horodyska dhe botuar nga shtëpia botuese polake “Pogranicze” i përket gjinisë së kujtimeve dhe është një ndër librat më të rëndësishëm të kujtesës.

“Angelus”, çmimi për Letërsinë e Europës Qendrore, vlerësohet si çmimi më i rëndësishëm në fushën e prozës së përkthyer në gjuhën polake

Lista përfundimtare e shtatë titujve të nominuar për “Angelus” 2025 do të zbulohet në shtator.

12 GUSHT 2025 / TREGIMET E RAMIZ GJINIT - TË LEXOJMË AUTORËT SHQIPTARË

Gazetarja Blerina Goce sugjeron tregimet e Ramiz Gjinit për lexim këtë verë. Tregimet e Ramiz Gjinit nuk vijnë me madhështi epike për të prekur lexuesin, ato vijnë me situata njerëzore, krejt të heshtura, me detaje të holla dhe fine, dhe kur tregimi mbaron, të bën për vete, sikur të ishe pjesë e rrëfimit. Kështu ndodh me këto tregime të këtij vëllimi, që vijnë të shkruar me një gjuhë të pasur, me një frazë të qartë - shpesh e kursyer, por që përcjellin shumë ngarkesë emocionale dhe shumë kuptim.





QKLL 2025

GUSHT




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

20 GUSHT 2025 / MBRËMJE POETIKE NË QYTETIN E ELBASANIT




Klubet e leximit - një formë e bukur për të përsosur raportin me leximin.



Një mbrëmje poetike në qytetin e Elbasanit, ku u bënë bashkë artdashës dhe mjaft të rinj që gjejnë prehje në rreshtat e librave.

Poezia dhe vargjet gjithmonë kanë shërbyer si ura për të lidhur brezat dhe kulturën e çdo qyteti.





QKLL 2025

GUSHT

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



27 GUSHT 2025 / TAKIM ME SHEFEN E KATEDRËS SË ALBANOLOGJISË NË MYNIH, ENKELEIDA KAPIA

U mirëprit në hapësirat e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit Enkeleida Kapia, shefe e Katedrës së albanologjisë në Mynih në universitetin elitar Ludwig-Maximilians, e cila është gruaja e parë që drejton këtë katedër pas viteve të tëra që u drejtua nga zoti Bardhyl Demiraj.

Viti 2025 është shpallur nga Katedra e albanologjisë në Mynih "Viti Martin Camaj" duke qenë se është 100-vjetori i tij i lindjes.

Në këtë takim u ndanë biseda mbi një figurë madhore të kulturës shqiptare, Martin Camaj si

dhe prodhimi i audiobooks për veprat poetike të Camajt.

Për znj. Enkeleida Kapia është shumë e rëndësishme që poezitë e Camajt të përçohen te brezat e rinj përmes zërit.

Në kuadër të 100-vjetorit të lindjes Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Katedrën e albanologjisë në Mynih do të organizojnë edhe një simpozium të veçantë ku do të referojnë personalitete të fushës së letërsisë e albanologjisë, studiues, pedagogë etj.

